Me armë zjarri me silenciator ishte nisur për të vrarë një person, policia i prish planin, arrestohet 37-vjeçari. Në pranga dhe shoqëruesi

01 Tetor, 2023 11:26

Madhësia e tekstit:

DURRËS

Policia e Durrësit parandalon kryerjen e një vrasjeje nga një shtetas me precedent të theksuar kriminal dhe rrezikshmëri të lartë.

I armatosur me armë zjarri me silenciator, me të cilën po shkonte për të vrarë një shtetas, Policia vë në pranga 37-vjeçarin Aldi Mustafa, i dënuar më parë brenda dhe jashtë vendit, për armë, drogë, kanosje dhe tentativë vrasjeje.

Sekuestrohen një armë zjarri "Scorpion" me silenciator dhe një sasi fishekësh luftarakë.

Policia e Durrësit ka dhënë sot detaje për arrestimin e Mustafës, i cili nuk është një emër i panjohur për bluto.

Specialistët e Sektorit për Hetimin e Krimeve të Rënda të DVP Durrës, falë inteligencës policore se një shtetas me precedent të theksuar kriminal po qarkullonte i armatosur dhe kishte planifikuar të kryente një vrasje, menjëherë kanë organizuar punën dhe në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale dhe "Shqiponjat", kanë zhvilluar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Tentativa".

Si rezultat, në lagjen nr. 15, Durrës, shërbimet e Policisë kanë lokalizuar automjetin me të cilin lëvizte shtetasi i armatosur dhe kanë ndërhyrë duke zbatuar të gjitha procedurat standarde për ndalimin e një automjeti.

Drejtuesi i automjetit nuk i është bindur urdhrit të punonjësve të Policisë për të ndaluar dhe ka tentuar të largohet me shpejtësi, por nuk ka mundur dot pasi është bllokuar nga shërbimet e Policisë.

Gjatë kontrollit në automjetin tip "Benz" që drejtohej nga shtetasi Aldi Mustafa, me pasagjer shtetasin Klevis Kurdiu, Policia, gjeti një armë zjarri "Scorpion" me silenciator dhe municion luftarak.

Në vijim të veprimeve, nga specialistët për Hetimin e Krimeve të Rënda të DVP Durrës u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve:

Aldi Mustafa, 37 vjeç, banues në Durrës, i dënuar më parë për disa vepra penale, brenda dhe jashtë vendit;
Klevis Kurdiu, 29 vjeç, banues në Durrës.

Nga informacionet që kishte siguruar Policia, dyshohet se shtetasi A. M. kishte planifikuar vrasjen e një shtetasi.

Në bashkëpunim me Prokurorinë vijojnë veprimet e thelluara hetimore për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të këtij rasti.

Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, i armëve shpërthyese dhe municionit" dhe "Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësve të policisë".

Për t'u bërë pjesë e grupit '**Balkanweb**' mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: Durres policia silenciator vrasje

TË NGJASHME

Arrestimi i 37-vjeçarit të rrezikshëm në Durrës, Balla falënderon policinë: Arritën të parandalonin një ngjarje të rëndë kriminale
01 Tetor, 2023

Vrasje, drogë e armë/ Bilanc "i frikshëm" në zbatim; policia: Muaj intensiv, 88 operacione, 937 autorë krimesh në pranga (Detajet)
01 Tetor, 2023

01 Tetor, 2023

Taboola Feed

Most Computer Owners Don't Know This. Do It Today!
This Could Be the Most Important Tip You Read This Year
Outlive Drive Updater | Sponsored
Click Here

This mineral will melt your belly fat fast
self-being review, SlimBrings | Sponsored

Dëshmia e bujshme: Unë e qëllova Xhevdet Mustafën dhe e lashë të vdekur, pasi ai na hyri në shtëpi dhe na vrau ...
Dëshmia e bujshme: Unë e qëllova Xhevdet Mustafën dhe e lashë të vdekur, pasi ai na hyri në shtëpi dhe na vrau ...
balkanweb.com


Dubai Villas Available At Cheapest Price Ever
Being Sold at Almost Nothing. Check Now.
SmartInfoSpace | Sponsored
Search Now

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Një proj aniktarëve shubi krimet/ Banda e Laert Hashlut para gjykatës, Ilmen në burg të arrestuarit
01 Tetor, 2023

Plagoset një minator në minierën e Martanesh/I në Bulqizë, u godit nga një masiv gurësh
01 Tetor, 2023

Zjarri në Durrësit të Fierit, Balla njëjës nga aftësitë: Kemi kërkuar të aktivizohet Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së
01 Tetor, 2023

Arrestohet 44-vjeçarja në Përmet, nuk denoncoi abuzimin seksual të vajzës së mitur, mashtroi dhe një të huaj në Facebook, u dënoj me 2 vite burgim
01 Tetor, 2023

Përfshihet nga flakët një prej lokaleve në Pazarin e ejerit të Korçës, dyshohet se zjarri shpërtheu aksidentalisht
01 Tetor, 2023

I akuzuar për 9 vjedhje me armë, arrestohet në Selanik 20-vjeçari shqiptar
01 Tetor, 2023

KATEGORIA VIDEO

Zjarri në Durrësit të Fierit, Balla njëjës nga aftësitë: Kemi kërkuar të aktivizohet Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së
01 Tetor, 2023

Segmenti Thumanë-Kashar, banorët e Bërzullës sërisht në protestë: Marrëvesheja ose do vetëfinancohemi
01 Tetor, 2023

Turq/ Sulm terrorist pranë parlamentit në Ankara, vriten kamikazi dhe një bashkëpunëtor i tij, plagosen dy policë
01 Tetor, 2023

"Terroristët qëlluan me armë automatike", ja si ndodhi sulmi pranë parlamentit në Ankara (Video)
01 Tetor, 2023

Video/ Spanjë, të paktën shtatë të vdekur nga një çarr në një klub nate në Murcia
01 Tetor, 2023

Si ansjëherë në park/ Banda e Laert Hashlut para gjykatës, bëndohet Elhanasi, shihni si është rrethuar nga forcat e policisë zona
01 Tetor, 2023

BalkanWeb TV | Google Play

Kërko këtu

LAJMET E FUNDIT

Një proj aniktarëve shubi krimet/ Banda e Laert Hashlut para gjykatës, Ilmen në burg të arrestuarit
01 Tetor, 2023

Plagoset një minator në minierën e Martanesh/I në Bulqizë, u godit nga një masiv gurësh
01 Tetor, 2023

Libi, shtyhet konferenca për rindërtimin e qytetit Derna
01 Tetor, 2023

VIDEO/ Publikohen pamjet, pas sulmit në Banjska, terroristët serbë hiin mallit dhe lënë në mugë mikun e tyre të plagosur
01 Tetor, 2023

Zjarri në Durrësit të Fierit, Balla njëjës nga aftësitë: Kemi kërkuar të aktivizohet Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së
01 Tetor, 2023

Rreth 300 produkte me zbritje/ Nëma e qeverisë italiane për të zbutur inflacionin, marketa e farmaci dje çmimesh për 3 muaj
01 Tetor, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.